



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4128/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>02-12-2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.11.2013, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3037/13, për z. Xhafer Dema – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3037/13, për zyrtarin e lartë z. Xhafer Dema – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat Ambulanta Pediatrike “Dr. Xhaferi”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Dema është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë e ushtron pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, dhe njëkohësisht është pronar në biznesin privat Ambulanta Pediatrike “Dr. Xhaferi”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të autorizoj një person të besueshëm që të udhëheq kompaninë.

Pas kësaj, z. Dema, ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3824/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka autorizuar një person të besueshëm për udhëheqjen e këtij biznesi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se është shmangur situata e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

